



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në Riga Technical University, Letoni**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët dhe stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Riga Technical University – RTU.

Llojet e mobilitetit për studentët përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik).
- **Master** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave për studentët: 1 semestër, (Semestri i parë, i vitit akademik 2025-2026).

Fushat e studimit për studentët: Të gjitha degët. (Studentët e interesuar të shohin lëndët që ofrohen nga RTU, sipas fakulteteve përkatëse, në linkun: [Course List for Exchange Studies - Google Sheets](#))

Numri total i studentëve: 4 studentë (Numri përfundimtar i studentëve të nominuar përcaktohet nga RTU.)

Përparësi në nominimin e studentëve, si dhe për aspektin financiar gjatë mobilitetit kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazuara. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;



- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është **B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në RTU lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Formatin e ‘‘Learning Agreement’’ e gjeni bashkëlidhur

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në RTU, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-un: [Course List for Exchange Studies - Google Sheets](#) si dhe: [Riga Technical University | Engineering Center in the Baltics](#)

Afati për aplikim për studentët: Deri më 1 prill 2025, ora 12.00

Aplikimi për studentët kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al

Lloji i mobilitetit për stafin akademik për mësimdhënie dhe stafin administrativ për trajnim:

Fusha e mësimdhënies / trajnimit: Të gjitha degët

Numri total i stafit: 2 (Numri përfundimtar i stafit të nominuar përcaktohet nga RTU.)

Koha e kryerjes së mobilitetit: Semestri i parë, i vitit akademik 2025-2026.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësies bazë dhe nga përgjegjësi i njësies kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t’u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik/administrativ;
- Dokumenti Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training)***.



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

**Plani i mobilitetit dhe periudha e propozuar e mobilitetit duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikani bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobilitetit si staf akademik ose administrativ në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin Staff Mobility for Teaching, ju lutemi klikoni te: [Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) .

Për informacion mbi RTU ju lutemi klikoni te: [Riga Technical University | Engineering Center in the Baltics](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 1 prill 2025, ora 12.00.

Pas përfundimit të mobilitetit të stafit, personi pjesëmarrës në RTU duhet të dorëzojë një raport te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, lidhur me aktivitetin.